



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 27 prill 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Duda Balje, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa dhe Naim Fetahu.

Mungoi: Valdete Bajrami

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në komision dhe Saranda Kaçiu, praktikante.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Sanije Berisha - OSBE, Qendresa Mulaj - ZAP, Agron Demi- Instituti GAP, Berat Thaçi- Instituti GAP, Artan Canhasi-KDI, Rejhane Zylfijaj-GIZ, Ramadan Islami- GIZ, Sylejman Blaku- Kosova Sot, Dardan Abazi- INDEP, Lulzim Peci- KIPRED, Albana Meha- GLPS, Visar Prebreza- Koha Ditore, dhe Florina Merovci- ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe bashkëpunim me Shoqërinë Civile;

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe bashkëpunim me Shoqërinë Civile;

Besnik Bislimi, kryetar i njoftoi të pranishmit për arsyen e organizimit të këtij takimi me shoqërinë civile. Nuk është diçka e re në vazhden e bashkëpunimit të KMFP-së dhe Shoqërisë Civile, edhe këtë legjislaturë. Unë mendoj se si KMFP, në raport me shoqërinë civile do të jemi shumë më transparent në kontekst të shpenzimit të parasë publike. Qëllimi i këtij takimi është gjetja e formave më të mira të bashkëpunimit në mes të këtyre institucioneve, dhe intensifikimi i bashkëpunimit. OJQ-të përmes pjesëmarrjes në dëgjime publike në komision na ndihmojnë në gjetjen e dobësive në fushën e menaxhimit të financave publike në Kosovë. Një pikë që është shqyrtuar edhe në mandatet e kaluara është pjesëmarrja e shoqërisë civile në punimet e komisionit që shërben si një asistent teknik me ekspertizën e tyre. Organizatat e Shoqërisë Civile po ashtu kanë mundësi të kontribuojnë në komision, siç ideja që na ka ardhur nga GLPS-ja për monitorimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike. Ne në bashkëpunim me shoqërinë civile mund të shkojmë nëpër komuna dhe t'i njoftojmë qytetarët për punën e komisionit dhe t'ju përgjigjemi pyetjeve të tyre, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutivit apo agjencie shpenzuese dhe është shumë me rëndësi që ju të na ndihmoni me inovacione apo ide të reja, të cilat neve si komision mund të na ndihmojnë se në cilat fusha të angazhohemi.

Përfitimet e bashkëpunimit në mes të KMFP-së dhe Shoqërisë Civile janë në kontekst që ta njoftojmë opinionin e gjerë lidhur me menaxhimin e shpenzimit të parasë publike. Ne si

komision mendojmë që të përgatisim një marrëveshje mirëkuptimi në mes të Shoqërisë Civile dhe KMFP-së, me qëllim të bashkëpunimit dhe hapave të përbashkët të veprimit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Po ashtu ju njoftoj se GIZ-i ka përzgjedhur zyrtarin i cili do të ndihmojë KMFP-në në punë dhe detyrat që i ka të parashtruara sipas fushëveprimit të komisionit, tha Bislimi dhe e hapi diskutimin.

Agron Demi – Ne tani e dy vite kemi nisur një fushatë për edukimin e qytetarëve se si mbushet buxheti dhe si shpenzohet paraja publike. Ne kemi krijuar një platformë online për çdo të hyrë dhe çdo të dalë në buxhetin e shtetit. Me këtë platformë në jemi fokusua se si Ministritë i shpenzojnë mjetet për dreka zyrtare, telefona zyrtar, karburante për vetura etj., për të parë se sa janë të përgjegjshme institucionet publike në shpenzimin e parasë publike. Në bazë të të gjeturave, shihet se jo të gjitha ministritë i janë përgjigjur kërkesës nga ana jonë për qasje në këto kategori të shpenzimeve dhe shihet që shumë institucione e tejkalojnë shpenzimin e parasë publike pa ndonjë arsytim.

Në këtë vit do të fillojmë përmes analizave sektoriale të buxhetit, qoftë tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore. Kërkesa jonë është që të fokusohemi në ato shpenzime që duken pak, por që e tregojnë natyrën e shpenzimeve të parasë publike, e cila është shqetësuese, që mungon transparenca në shpenzimin e parasë publike.

Ne kemi kërkuar publikimin e emrave të zyrtarëve që bëjnë shpenzimin e parasë publike, për shkak që ndryshe është kur të publikohet emri i institucionit e ndryshe emri i personit. Kemi krijuar një databazë të gjerë të të dhënave dhe kohëve të fundit, ne jemi ftuar edhe nga Zyra e Auditori të Përgjithshëm për të ndihmuar auditimin e performancës. Kjo është edhe fusha ku ne si shoqëri civile mund të japim kontribut për KMFP-në, se ato para që po ndahen për projekte të ndryshme, a po e arrijnë qëllimin e duhur apo jo.

Berat Thaçi – Një bashkëpunim tjetër me komisionin do të ishte avokimi që organizatat buxhetore, duke përfshirë ministritë dhe komunat t'i publikojnë të dhënat e tyre në ueb faqen zyrtare të institucionit. Fjala vjen nëse organizatat e shoqërisë civile dhe komisionet arrijnë me i bind që organizatat me publiku një dokument që quhet kartela analitike e kontos, besoj që është një hapë drejt avancimi të transparencës së parasë publike. Ky dokument tregon për çdo shpenzim të parasë publike, në cilën datë u shpenzua, nga kush u shpenzua dhe ku u shpenzua.

Ky dokument do të rriste në mënyrë të drejtpërdrejtë transparencën e shpenzimit të parasë publike.

Agron Demi – Ne kemi bërë një analizë se si bëhet dhënia e subvencioneve nga ana e ministrive, p.sh. Ministria e Integrimeve Evropiane, 75% të subvencioneve që i ka dhënë, janë për kulturë. Këto nuk i kemi gjetur në raportet e auditorit. Në raport vetëm thuhet që ka keqpërdorime në ndarjen e subvencioneve, por jo edhe të saktësohet se ka pasur ndarje të mjeteve për një fushë që nuk e mbulon ky institucion. Nëse i mbledhim të gjitha raportet e auditorit, vërejmë se nuk ka ndonjë të gjetur që tregon qartë se një institucion ndanë mjete për nga natyra që nuk i takon atij institucioni. Nëse i mbledhim të gjitha raportet e auditorit, ku thuhet se janë audituar mbi 1.3 miliard euro dhe se vlera e keqpërdorimit vlerësohet se është me miliona euro. Po ashtu tani në kohën kur pritet hartimi i Ligjit mbi Auditorin e Jashtëm, është mirë që ti lihet një pavarësi auditorit, ku raportet e auditimit të kenë një dozë të gjykatës. Mendoj se gjetjet e raporteve të auditimit të kenë një shkallë të gjykimit, derisa gjykata të vendos të kundërtën.

Albana Meha- Unë do të flasë tani sa i përket Ligjit mbi Financimin e Subjekteve Politike, dhe auditimin e subjekteve politike. Po bëhen më shumë se dy vite që Kuvendi ende nuk ka arritur të bëjë auditimin e subjekteve politike, për faktin se ligji i ndryshuar mbi financimin e subjekteve politike ia ka dhënë këtë të drejtë Kuvendit për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve për auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike. Pra, nga viti 2012 nuk është bërë ndonjë auditim për subjektet politike. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile, ne si shoqëri civile jemi të kënaqur dhe kjo dallon shumë në krahasim me Qeverinë sepse atje i kemi në shumicën e rasteve dyert e mbyllura.

Besnik Bislimi, kryetar - Sa i përket çështjes së ngritur për auditimin e subjekteve politike, ne si komision qysh në muajin janar 2015 e kemi trajtuar këtë çështje, mirëpo, kjo ka mbetur përgjegjësi e administratës së Kuvendit për të gjetur mënyrat dhe modalitete në terren për implementimin e këtij obligimi ligjor.

Ali Sadriu- Mendoj se kjo çështje është trajtuar në komision edhe në legjislaturën e kaluar, mirëpo Kuvendi nuk ka arritur ende të zgjedhë operatorët ekonomikë për auditimin e

subjekteve politike. Kjo tani është përgjegjësi complete e Zyrës së Prokurimit dhe administratës së Kuvendit.

Artan Canhasi- Sa i përket programeve që ne si OJQ i kemi ndihmuar institucionet në punën e tyre, ju lutem që të shfrytëzoni resurset që ofron KDI-ja. Ne për nevoja të hulumtimeve mund t'ju ndihmojmë, përmes angazhimit të ekspertëve në fusha të veçanta. Po ashtu, KDI-ja është duke përgatitur një studim të thellë për shkaqet dhe pasojat e korrupsionit. Ky hulumtim përfshinë 15 fusha. Përzgjedhja e auditorëve për auditimin e subjekteve politike, është një njollë e zeze nëse komisioni nuk arrin ta zgjedhë këtë çështje. Dobësi të shumta po ashtu në fushën e prokurimit duhet të analizohen dhe të eliminohen.

Lulzim Peci- Unë do të kërkoja nga komisioni që përmes sekretarisë së komisionit të përgatitë një bazë të të dhënave sa i përket punimeve që bëjnë OJQ-të, e të cilat punime kanë natyrën e punës së KMFP, të ruhen dhe të publikohen në këtë bazë të të dhënave të Komisionit.

Besnik Bislimi- Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ-in, ne do të kemi dy ose tre studentë, të cilët do të kryejnë praktikën në komisionin tonë. Detyrat primare do të jenë mbështetja e anëtarëve të komisionit me informata bazike, dhe krijimi i kësaj databaze për mbështetjen e sekretarisë së komisionit. Edhe ne kemi shqyrtuar punën e përcaktimit të agjendave më përpara, por puna jonë varet nga ardhja e raporteve në komision.

Sanije Berisha - OSBE ka bërë monitorimin e punës së Komisionit në aspektin e pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Po ashtu ne kemi bërë edhe përcjelljen e shqyrtimit të raporteve nga ana e Komisionit dhe të gjeturat e këtij komisioni. Njëra prej rekomandimeve që po merret parasysh nga komisioni, të cilin e kemi sugjerua ne –OSBE-ja, është bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në këtë komision. Ne kemi rekomanduar që të ketë bashkëpunim, edhe me komisionet tjera funksionale, gjë të cilën komisioni tani më është duke e praktikuar. Gjithashtu ne kemi rekomanduar që të krijohet një databazë dhe të mbahen konferenca për shtyp nga ana e komisionit për të gjeturat.

Shqipe Krasniqi – Kuvendi posedon një databazë për regjistrim të shoqërive civile, por gjithashtu Kuvendi ka edhe një deklaratë për partneritet me organizatat e shoqërisë civile, që është hartuar në bashkëpunim mes deputetëve dhe shoqërisë civile. Kuvendi është në fazën ku do të bëjë seleksionimin e organizatave të shoqërive civile, të cilat do të marrin pjesë në këtë partneritet. Gjithashtu, çdo fundviti, administrata në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me deputetë do të organizojnë një konferencë vjetore, për të hartuar një plan që lidhet me deklaratën. Ne e kemi një projekt dyvjeçar me USAID-in, i cili u dedikohet organizatave të shoqërisë civile për mënyrën e transparencës së bashku me Kuvendin. Nëse komisioni ka nevojë për analistë të fushave të caktuara, atëherë KDI-ja, në bazë të memorandumit të nënshkruar e ka për obligim që të ofrojë analist të kësaj fushe. Konsiderojmë që organizatat e shoqërisë civile janë këtu për mbështetje të deputetëve dhe gjithashtu për të qenë bashkudhëtar të këtyre ndryshimeve.

Besnik Bislimi- Ne do të përpiqemi që ta shfrytëzojmë këtë mundësi të ofruar nga KDI-ja për analiza dhe hulumtime. Gjithashtu edhe për këtë projektin e USAID-it, por pa u kufizuar në atë projekt, për dijen që është akumuluar edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Ne kemi më shumë nevojë për aktivitetet e shoqërisë civile, në mbikëqyrjen e financave publike dhe Komisionit të Integriteteve Evropiane.

Saniye Berisha- Kjo çka është duke bërë OSBE-ja, është një databazë tjetër e hulumtimeve, e cila është vetëm për Komisionin e Financave. Kjo do t'ua lehtësojë punën në përcjelljen e rekomandimeve që dalin nga zyra e auditorit, si për komisionin gjithashtu edhe për organizatat e shoqërisë civile.

Besnik Bislimi- Në takimet me shoqërinë civile, më janë prezantuar dokumente për hulumtimet në fushën e prokurimit, përmirësimit të kualitetit të administratës publike, mirëpo, këto dokumente tash për tash mund ti disponoj vetëm unë. Por, nëse krijohet një databazë ku do të kishin qasje në këto dokumente të gjithë deputetët dhe të gjithë të interesuarit, kjo sigurisht që do të ngritë kualitetin e diskutimit në komision.

Qëndresa Mulaj- ZAP-i funksionon në bazë të të drejtave dhe përgjegjësi që janë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin e Auditorit të

Përgjithshëm. Ne si ZAP kemi gjetur partnerë të bashkëpunimit, të cilët na kanë mbështet në punën tonë, mirëpo një hallkë e rëndësishme lidhur me të gjeturat dhe prezantimet tona janë edhe organizatat e shoqërisë civile. Ne jemi duke e finalizuar sezonin e auditimit për vitin 2014/2015. Kemi një plan tentativë, të cilit po mundohemi ti përmbahemi dhe besoj që deri në fund të qershorit ne do të dalim me raporte të rregullsisë, ndërsa sa i përket auditimi të performancës po vazhdojmë dhe së shpejti pritet publikimi i Raportit mbi Sistemin e Menaxhimit në RTK.

Besnik Bislimi, kryetar- Meqenëse nuk pati të interesuar për të diskutuar nga të pranishmit, ky takim do të forcojë bashkëpunimin në mes Komisionit tonë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile. Po ashtu, shpresoj se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe e inkurajoj shoqërinë civile në konkretizimin e këtij bashkëpunimi, të cilin do t'ua shpërndajmë të gjitha organizatave që kanë qenë prezent dhe që kanë dëshirë të na bashkëngjiten në rrugëtimin tonë të përbashkët.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi